



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1410/13 prot.

Datë 31/07/2026

V E N D I M
Nr. 908/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31/07/2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 794/2026, datë 12.06.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02 02-2026, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues: “INSTANT.AL” SHPK me NIPT (L81506043D), me adresë: Rruga “Ali Demi” përballë Fushës së Zezë, Tiranë, zona kadastrale 8150.

“OPTIMA COMMUNICATION” SHPK me NIPT (K71903025A), me adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

“PC STORE” SHPK me NIPT (L01606034A), me adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Portual Durrës, me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021

“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 12.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 794/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.*
2. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
3. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.*
4. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
5. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
6. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Instant” SHPK, nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK si dhe nga operatori ekonomik “OPTIMA COMMUNICATION” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

I.2. Me shkresën nr. 2320 prot., datë 29.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1410/10 prot., datë 01.07.2026, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durres, ka përcjellur informacionin për rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 794/2026 datë 12.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 2320 prot., datë 29.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1410/10 prot., datë 01.07.2026, autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durres, ka përcjellur informacionin për rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 794/2026 datë 12.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka bashkëngjitur dokumentat nga ku informon kryerjen e rivlerësimit sipas vendimit nr. 794/2026 datë 12.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik konstatohet se autoriteti ka vijuar me rivlerësimin sipas vendimit të KPP për operatorin ekonomik duke zbatuar kështu vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-71079-12-04-2025, me objekt “Digital Port”, me fond limit 14,900,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02-02-2026 , nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durres.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu